

# **Raportimi i medias mbi Reformën në Drejtësi**

*Periudha e monitorimit: Prill-Qershor 2019*

Ky raport u hartua nga Instituti Shqiptar i Medias në kuadrin e projektit “Fuqizimi i rolit të medias së pavarur në procesin e reformës në drejtësi në Shqipëri,” i mundësuar nga ‘Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën’, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

## **RAPORTIMI I MEDIAS MBI REFORMËN NË DREJTËSI, PRILL-QERSHOR 2019**

Periudha në monitorim përkon me përplasjen më të nxehtë politike të viteve të fundit në vend duke ndikuar rrjedhimisht edhe në përmbajtjen mediatike. Edicionet e lajmeve, përmbajtja online dhe faqet e shtypit kanë qenë të mbushura kryesisht me informacione që lidhen me krizën politike.

Megjithatë, fakti se edhe zhvillimet që kanë të bëjnë me Reformën në Drejtësi kanë qenë të rëndësishme i ka bërë lajmet në këtë sektor konkurruese, duke gjetur një hapësirë të mirëfilltë në media.

Të tilla janë vettingu i emrave të njohur të Sistemit të Drejtësisë; burgosja për herë të parë e një gjyqtari për shkak të një procesi të nisur nga vettingu apo intensifikimi i punës për të ngritur SPAK-un , duke iu imponuar në njëfarë mënyre redaksive të lajmeve për t'i pasqyruar ato.

Duke patur parasysh zhvillimet e mësipërme, përzgjedhja e kampionit është bërë e tillë që të përfshijë qëndrimet mbizotëruese mbi Reformën në Drejtësi, duke marrë në konsideratë edhe që mediat të kishin një audiencë të mirëfilltë.

Me këtë kriter nga televizionet janë përzgjedhur për t'u monitoruar edicionet qendrore të lajmeve të “Ora News” dhe “News 24”, nga shtypi janë përzgjedhur “Shqiptarja.com” dhe “Shekulli”, ndërsa nga mediat online u monitoruan portali “Albeu.com” dhe “Tema Online”.

Monitorimi është bërë duke u fokusuar te lajmet për Reformën në Drejtësi në përgjithësi, si dhe specifikisht te zhvillimet mbi vettingun dhe ngritjen apo funksionimin e KLP/ KLGJ/ SPAK.

Sa i përket portaleve, janë monitoruar çdo ditë për tre muaj me radhë rubrikat përkatëse “Aktualitet” tek “Albeu.com” dhe “Kronikë” tek “Tema Online”, ku dhe është konstatuar se janë klasifikuar lajmet mbi Reformën në Drejtësi. Janë identifikuar të gjitha publikimet mbi Reformën në Drejtësi në përgjithësi, duke i nëngrupuar më pas në lajme mbi vettingun apo mbi KLP/KLGJ/SPAK.

Në përfundim është bërë një vlerësim cilësor mbi përmbajtjen dhe gjuhën e përdorur, si dhe vlerësim statistikor në lidhje me raportin e lajmeve mbi Reformën në Drejtësi dhe totalit të lajmeve ditore të botuara në këto media online

Për gazetat “Shqiptarja.com” dhe “Shekulli” janë përzgjedhur 45 numra për secilën prej tyre, për periudhën 1 prill - 30 qershor 2019, ku krahas përmbajtjes është bërë edhe një vlerësim mbi hapësirën që u është dhënë lajmeve.

Për televizionet informative “Ora News” dhe “News 24” janë vëzhguar 45 edicione qendrore lajmesh përgjatë të njëjtës periudhë, duke analizuar posaçërisht përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e lajmeve mbi Reformën në Drejtësi në tërësi, si dhe vettingun dhe KLP, KLGJ dhe SPAK në veçanti.

Në fund është bërë një vlerësim statistikor dhe cilësor i raportimeve në lidhje me zhvillime të rëndësishme gjatë periudhës nën monitorim, siç është vendimi ndaj gjyqtarit Admir Thanza, procesi i rishqyrtimit të vendimit të KPK-së për kualifikimin e kreut të Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori apo vlerësimi i kreut të Gjykatës së Apelit të Shkodrës, Fuat Vjerdha.

## **1. NJË PASQYRË E GJETJEVE STATISTIKORE**

### **1.1. Televizionet**


Nga 701 kronika të transmetuara nga “News 24” në edicionet e monitoruara, vetëm 13 prej tyre ose 1.85% e totalit janë mbi Reformën në Drejtësi apo zhvillime që lidhen me të, pjesa tjetër mbizotërohet nga lajme mbi çështjet ditore të politikës.

Ndërkohë, në 430 kronikat e 45 edicioneve qendrore të lajmeve të “Ora News” që janë monitoruar janë konstatuar 18 kronika mbi Reformën në Drejtësi apo aspekte të saj, të cilat përbëjnë 4.2% të totalit të kronikave të transmetuara.

Edhe pse në dukje tek “Ora News”, nga pikëpamja sasiore, ka një numër më të madh kronikash, nuk vërehet ndonjë ndryshim i mirëfilltë me “News 24” sa i përket kohëzgjatjes. Totali i 18 kronikave të “Ora News” kanë një kohëzgjatje prej 23 minutash, kurse totali i 10 kronikave të “News 24” kanë një kohëzgjatje prej rreth 20 minutash.

Nga monitorimi është konstatuar se kronikat mbi Reformën në Drejtësi të “News 24”, si njësi, kanë qenë më të gjata krahasuar me ato tek “Ora News”. Kjo diferencë lidhet edhe me faktin se edicioni i lajmeve të “News 24” ka një kohëzgjatje mesatare prej 45-55 minutash krahasuar me kohëzgjatjen mesatare prej 18-22 minutash të edicionit qendror të lajmeve në “Ora News”.

Ndryshe nga portalet, ajo që vihet re tek televizionet ka të bëjë me një fokus më të shtuar në aktivitetin e institucioneve që lidhen me Reformën në Drejtësi, si KLGJ dhe KLP, duke dalë kështu nga qerthulli i raportimit rutinë mbi vendimet e KPK-së për kualifikim apo shkarkim gjyqtarësh dhe prokurorësh. Kjo rrjedh edhe nga fakti se bëhet fjalë për edicionet qendrore të lajmeve ku kronika duhet të ketë një ndikim dhe peshë të caktuar për t'u "kualifikuar" që të listohet aty.



**Figurë 1** Pasqyrë statistikore e gjetjeve në televizionet "Ora News" dhe "News24" gjatë periudhës prill-qershor 2019

Kështu për shembull, nga totali prej 10 kronikash të transmetuara në "News 24" mbi Reformën në Drejtësi, 8 prej tyre kanë pasqyruar zhvillime nga KLP apo KLGJ dhe vetëm 2 kanë të bëjnë me KPK-në. Edhe në rastet kur është raportuar mbi KPK kanë qenë kronika që lidheshin me personazhe të njohur të Sistemit të Drejtësisë, siç është për shembull procesi i vlerësimit të gjyqtarit Zaganjori apo apelimi i vendimit kualifikues të KPK-së për Kryeprokuroren e Krimeve të Rënda, Donika Prela. E njëjta gjë, më e theksuar vërehet tek "Ora News", ku nga 18 kronika të transmetuara në total, 13 prej tyre lidhen me SPAK/KLP/ KLGJ, ndërsa vetëm 5 lidhen me vettingun.

Vlen të theksohet se përveç edicionit qendror të lajmeve të datës 8 prill të "News 24", në asnjë rast tjetër nuk është konstatuar që edicionet të nisin me kronikë të parë nga zhvillime mbi Reformën në Drejtësi.

Gjatë monitorimit të edicioneve qendrore të lajmeve të “Ora News” dhe “News 24” është vërejtur një numër më i vogël kronikash në raport me televizionet kombëtare Top Channel dhe Tv Klan të monitoruar gjatë periudhës janar-mars 2019. Kjo në dukje është anormale pasi natyra informative e televizioneve duhet të pasqyronte të kundërtën.

Duke mos ditur nëse kemi të bëjmë me një interes më të ulët të dy televizioneve informative ndaj Reformës në Drejtësi apo ky numër më i vogël kronikash vjen për shkak të klimës së tensionuar politike, është bërë një krahasim i edicioneve qendrore të lajmeve të Tv Klan dhe Top Channel me edicionet qendrore të lajmeve të “Ora News” dhe “News 24” në të njëjtat data jashtë periudhës prill-qershor.

Nga krahasimi nuk vërehet ndonjë diferencë e madhe në numër kronikash, duke na dhënë të kuptojmë se ndryshimi gjatë kësaj periudhe vjen për shkak të klimës së tensionuar politike ku lajmet nga ky sektor kanë marrë më tepër hapësirë.

Thuajse në të gjitha rastet, gjuha e përdorur nga televizionet mbi Reformën në Drejtësi është neutrale. Krahas dhënies së hapësirës për zhvillimet mbi reformën, janë vërejtur kronika që shtrojnë problematika rregullimi i të cilave do të përmirësonte reformën në tërësi.


Theksi vendoset te nevoja që procesi i vettingut duhet të zhvillohet më shpejt dhe institucionet përgjegjëse, kryesisht KLGJ dhe KLP, duhet të marrin masa të shpejta me qëllim mosbllokimin e sistemit gjyqësor për shkak të shkarkimeve të prokurorëve dhe gjyqtarëve nga vettingu.

## **1.2. Mediat online**

Për shkak të hapësirës së pakufizuar online, portalet paraqiten me një numër më të madh publikimesh në raport me televizionet dhe gazetatat e monitoruara. Ky është fenomen i hasur edhe gjatë periudhës janar-mars. Megjithatë, konkurrenca mes tyre për të hedhur lajmin i pari, shtoi edhe mungesën e ekspertizës në këtë fushë, bën që shpesh lajmet mbi Reformën në Drejtësi të jenë të cinguara në përmbajtje.

Nga monitorimi konstatohet se mbulimi i veprimtarisë së institucioneve të ngritura në kuadër të Reformës në Drejtësi bëhet nga portalet duke iu referuar burimeve të tjera mediatike.


Situata e konstatuar nxjerr edhe njëherë në pah problematikën e mediave shqiptare në lidhje me stafet e vogla, të cilat duhet të raportojnë për një mori çështjesh duke e patur të pamundur fizikisht dhe profesionalisht të mbulojnë zhvillime që kërkojnë një formim specifik të gazetarit siç është Reforma në Drejtësi.



**Figurë 2 - Pasqyrë statistikore e gjetjeve në portalin "Albeu.com" gjatë periudhës prill-qershor 2019**

“Albeu.com” publikoi gjithsej 2 267 lajme në rubrikën “Aktualitet” gjatë tre muajve që zgjati periudha e monitorimit. Duhet shpjeguar, në shërbim të leximit më të qartë të statistikave, se portali klasifikon në këtë rubrikë të gjitha lajmet që kanë të bëjnë me politikën, kronikën dhe socialen që ndodhin brenda territorit të Shqipërisë.

Në total, 65 prej këtyre publikimeve ose 2.9% e totalit të lajmeve të gjetura në këtë rubrikë kishin lidhje të drejtpërdrejtë me Reformën në Drejtësi dhe institucionet në shërbim të saj. Nëse do të tregoheshim edhe më tepër specifike, 47 lajme kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe 18 me SPAK/ KLP/ KLGJ.



**Figurë 3 Pasqyrë statistikore e gjetjeve në "Tema Online " gjatë periudhës prill-qershor 2019**

Sa i përket “Tema Online”, gjatë periudhës në monitorim, në rubrikën “Kronikë”, janë konstatuar 808 lajme, nga të cilat 97 prej tyre ose 11.2% e totalit të lajmeve të hedhura në këtë rubrikë lidhen drejtpërdrejt me Reformën në Drejtësi. Specifikisht, 74 lajme raportojnë mbi vettingun dhe 21 për SPAK/KLP/KLGJ.

Për t’u theksuar është fakti që edhe pse jemi në prag të ngritjes së SPAK-ut, ndërsa KLP dhe KLGJ funksionojnë, vëllimin më të madh të lajmeve e përbëjnë ato nga procesi i vettingut. Ky është një fenomen i vërejtur edhe gjatë monitorimit në periudhën janar-mars 2019, gjë e cila të lë të kuptosh se Reforma në Drejtësi te portalet perceptohet kryesisht vetëm përmes procesit të vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në asnjë rast nuk janë konstatuar publikime që të shpjegojnë funksionin dhe qëllimin e ngritjes së SPAK-ut. Mbi SPAK-un raportohet kryesisht përmes akuzave të ndërsjella të politikanëve, të cilët paralajmërojnë njëri-tjetrin se ngritja e këtij institucioni do t’i burgosë.

### **1.3. Mediat e printuara**


Pavarësisht agjendës mjaft të ngjeshur të politikës për shkak të zhvillimeve të vrullshme gjatë muajve që përkojnë me zhvillimin e monitorimit, në të dyja gazetat vërehet një prani optimale e lajmeve mbi Reformën në Drejtësi. Vendimet e komisioneve të vlerësimit për gjyqtarë apo prokurorë të rëndësishëm kanë gjetur hapësirë të mirëfilltë në gazetatat e monitoruara. Gjithashtu konstatohet një gatishmëri për t’i pasqyruar këto zhvillime edhe në faqen e parë të gazetave.

Konstatohet që “Shekulli” të ketë publikuar mesatarisht gjysmë faqe lajme mbi reformën çdo ditë krahasuar me ¼ të faqes të publikuar mesatarisht te “Shqiptarja.com”.

Nga monitorimi është konstatuar se “Shqiptarja.com” bën një ndjekje më proaktive të zhvillimeve mbi reformën, duke raportuar rregullisht mbi procesin e vlerësimit të gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe atë të ngritjes së KLP dhe KLGJ. Gazeta ka gazetarë të dedikuar që raportojnë për reformën, ku vihen re shpesh edhe qëndrime redaksionale mbi gjyqtarë apo prokurorë të caktuar, ndërsa raportimi te “Shekulli” duket të jetë më spontan, duke u ndikuar nga zhvillimet ditore.

Te “Shekulli”, lajmet mbi Reformën në Drejtësi publikohen kryesisht në faqet 2-3 (rubrika Radar) dhe 6-7 (rubrika Thellë), ndërsa “Shqiptarja.com” i publikon kryesisht në faqet 4-5, ndërkohë që janë konstatuar shpesh lajme edhe në faqet 8-9.






**Figurë 1** Gjetjet statistikore në gazetën "Shqiptarja.com" gjatë periudhës prill-qershor 2019

Sa i përket hapësirës vërehet një diferencë mes dy gazetave, ku gjatë periudhës së monitoruar rezulton që "Shekulli" të ketë publikuar një total prej 21.5 faqesh përmbajtje mbi Reformën në Drejtësi. Ndërkohë gjatë të njëjtës periudhë, hapësira e lajmeve mbi reformën të publikuara te "Shqiptarja.com" rezulton të jetë pak më shumë se 12 faqe.

Duhet theksuar se kjo diferencë e madhe në hapësirë vjen për shkak të dizajnit të ndryshëm që përdorin të dyja gazetatat dhe jo prej interesit më të ulët të treguar nga "Shqiptarja.com" ndaj zhvillimeve në Reformën në Drejtësi.

Dizajni i përdorur nga "Shekulli" ka të bëjë kryesisht me lajmin e gjatë, foton e madhe, të shoqëruar me elementë të tjerë si infografika që lidhet me të njëjtin lajm. Ndërkohë "Shqiptarja.com" vërehet të përdorë edhe lajme të shkurtra në brendësi të saj, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me vendimet e KPK-së, gjë që e lejon gazetën që në një hapësirë më të vogël të botojë një numër më të madh lajmesh.



**Figurë 2 Gjetjet statistikore në gazetën "Shekulli" gjatë periudhës prill-qershor 2019**

Kjo vërehet edhe nëse do të krahasojmë numrin total të lajmeve mbi Reformën në Drejtësi të publikuara tek të dyja gazetat, ku “Shekulli” numëron 49 të tilla, kurse “Shqiptarja.com” ka botuar 40 lajme.

Diferenca si në hapësirë ashtu edhe në numër lajmesh është vendosur në muajin qershor ku “Shqiptarja.com” duket të jetë e fokusuar kryesisht te kriza politike në vend duke i dhënë krahasimisht më pak hapësirë Reformës në Drejtësi (Shiko grafikun).

Pavarësisht linjave editoriale të ndryshme, vërehet se të dyja mediat kanë një qasje pozitive ndaj Reformës në Drejtësi ku herë pas here janë konstatuar artikuj që bëjnë thirrje për përfundimin sa më parë të vettingut dhe procesit të ngritjes së institucioneve përgjegjëse për gjykatat dhe prokurorinë.

## **2.ÇËSHTJE DHE PROBLEMATIKA**

### **2.1. Mosfunksionimi i institucioneve**

Gjatë javës së fundit të majit në edicionet qendrore të lajmeve të Ora News vërehet një vëmendje ndaj problemeve që ka sjellë vettingu në funksionimin e prokurorive dhe gjykatave për shkak të numrit të madh të prokurorëve dhe gjykatësve të shkarkuar. Në edicionin e lajmeve të datës 21 maj spikat lajmi për vendimmarrjen e KLP-së lidhur me zëvendësimin me emra të rinj të krerëve të prokurorive të rretheve të shkarkuar nga vettingu.

Ndërkohë, në edicionin e lajmeve të datës 22 maj, “Ora News”<sup>1</sup> shpreh shqetësimin se shkarkimi i gjyqtarit Edmond Islamaj nga Kolegji i Posaçëm i Apelit ka nxjerrë praktikisht jashtë funksionit edhe Gjykatën e Lartë krahas Gjykatës Kushtetuese.

Një ditë më pas, “Ora News”<sup>2</sup> i kthehet problematikës së nxjerrjes jashtë funksionit të gjykatave prej procesit të tejzgjatur të vettingut, si dhe të ngritjes së institucioneve të reja. Në këtë edicion lajmesh spikat një intervistë e ish-ministrit të Drejtësisë, Eduart Halimi. Në intervistën që zgjat 2:30 minuta, Halimi shpreh domosdoshmërinë e Reformës në Drejtësi, por sipas tij jo në formën që është ndërtuar aktualisht, e cila “nuk ka lënë gjykatë në këmbë”.

Televizioni i mëshon sërish kësaj problematike disa ditë më pas<sup>3</sup> ku tashmë përmes zërit të juristëve jepet zgjidhja për mbajtjen në funksion të gjykatave, përfshi edhe Gjykatën e Lartë, përmes delegimit të gjyqtarëve nga KLGJ. Kronika, e cila zgjat 1.32 minuta thekson gjithashtu se në Gjykatën e Lartë mbetën për t’u shqyrtuar rreth 32 mijë dosje, gjë të cilën e kanë krejtësisht të pamundur ta bëjnë dy gjyqtarët e mbetur në të.

E njëjta problematikë konstatohet edhe nga “News 24”, ku në edicionin e lajmeve të datës 20 prill<sup>4</sup> është transmetuar një kronikë përmes të cilës theksohet se gjykatat janë në kaos për shkak të shkarkimit të gjykatësve nga vettingu. Në kronikë përmendet fakti se pas daljes jashtë funksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, probleme në funksionimin e tyre vërehen edhe në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe të apelit.

Shqetësimi për daljen jashtë funksionit të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe funksionimin me probleme të prokurorive dhe gjykatave të rretheve e gjejmë të shprehur edhe në portalet e monitoruara.

Përmes një shkrimi të postuar më datë 2 prill, "Tema" thekson se vettingu ka larguar një pjesë të mirë të krerëve të gjykatave të rretheve<sup>5</sup>, ndërsa "Albeu.com"<sup>6</sup>, ka renditur gjykatat të cilat nuk kanë drejtues për shkak të procesit të vlerësimit duke shtruar pyetjen se deri kur do të vazhdohet

---

1 <http://www.oranews.tv/emisionet/edicioni-i-lajmeve/rama-leter-bashes-te-ulemi-pe-dialog-pa-kushte-basha-asnje-hap-pas>

2 <http://www.oranews.tv/emisionet/edicioni-i-lajmeve/shtyhen-zgjedhjet-gjermania-gati-te-negocioje-mes-rames-e-bashes>

3 <http://www.oranews.tv/emisionet/edicioni-i-lajmeve/hetimet-zgjedhjet-arta-marku-gati-vendimet-dosjet-339-e-184>

4 <https://www.youtube.com/watch?v=rcwpPSyThNA>

5 <http://www.gazetatema.net/2019/04/02/nje-vit-pas-vettingut-gjykata-te-zbrazura-nga-procesi-i-ethshem-e-sistematik/>

6 <http://www.albeu.com/shqiperi/gjykatat-me-vendime-kontradiktore-paqartesi-per-vijimin-e-punes-me-dosjet/387313/>

me këtë praktikë pasi qytetarët po përballen me vonesa në gjetjen e të drejtës, gjë që në vetvete është një shkelje.

Ndërkohë, “Shqiptarja.com” shkruan më datë 3 maj se “Gjykata e Lartë është në prag të mbylljes pas shkarkimit të gjyqtarit Edmond Islamaj”<sup>7</sup>. Gazeta thekson faktin se në detyrë ka mbetur vetëm një gjyqtare, por edhe asaj i ka mbaruar mandati. Në të njëjtën datë “Shekulli” i referohet këtij fenomeni duke shkruar se “Gjykata e Lartë” është në kolaps pas shkarkimit të gjyqtarit Islamaj<sup>8</sup>.

Në një shkrim tjetër me titull: “Gjykata e Lartë në prag mbyllje, anëtari i fundit pa mandat,”<sup>9</sup> “Shqiptarja.com” bën një përmbledhje të shkarkimeve të rëndësishme në Sistemin e Drejtësisë duke numëruar prokurorët dhe gjyqtarët e larguar, ndërkohë që theksohet pamundësia e funksionimit të disa gjykatave të rëndësishme.

## 2.2. Vetting me pikëpyetje

Mungesa e ekspertizës ka bërë që trajtimi i zhvillimeve mbi reformën të bëhet sipërfaqësor duke raportuar kryesisht vetëm mbi çështje ditore që rrjedhin nga vendimet e komisioneve të vlerësimit, megjithatë në raste të veçanta janë hasur edhe publikime të thelluara që shtrojnë problematika që kanë të bëjnë me kriteret mbi të cilat po bëhet vlerësimi i figurës së anëtarëve të Sistemit Gjyqësor.

Përmes një shkrimi të botuar në 22 prill, “Albeu.com” pas një verifikimi të të gjithë vendimeve të KPK-së deri në atë moment konstaton se një pjesë e mirë e gjyqtarëve janë përjashtuar duke marrë në konsideratë vetëm kriterin e pasurisë, ndërsa ligji parashikon se një anëtar i Sistemit të Drejtësisë vlerësohet edhe për dy kriteret e tjera, si kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësisë profesionale<sup>10</sup>. Në shkrim shtrohet problematika që edhe nëse është ligjore, kjo mënyrë e të vlerësuarit të gjyqtarëve në thelb ka probleme në raport me frymën e Reformës në Drejtësi, ndërsa njëkohësisht shkruhet se një pjesë e mirë e ekonomisë së vendit është informale.

---

<sup>7</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/gjykata-e-larte-ne-prag-mbyllje-anetari-i-fundit-pa-mandat?r=kh1>

<sup>8</sup> “Komisioneri kërkon shkarkimin e Islamaj,” *Shekulli*, 3 maj, 2019, f.2.

<sup>9</sup> 3 maj 2019, f.7.

<sup>10</sup> <http://www.albeu.com/kryetitull/a-mjafton-vetem-pasuria-per-te-pastruar-sistemin-e-drejtësisë-ne-shqipëri/457907/>

Ndërkohë, në një shkrim tjetër “Tema” raporton se komisionet e vlerësimit nuk kanë marrë në konsideratë raportet e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) përmes të cilave bëhet vlerësimi i figurës dhe aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>11</sup>.

Shkrimi gjithashtu pasqyron me statistika se në sa raste nuk janë marrë në konsideratë raportet e DSIK për dhënien e vendimeve për gjyqtarë apo prokurorë, gjë që do të thotë se vlerësimi është bërë kryesisht vetëm mbi kriterin pasuror.

### 2.3. Ndërkombëtarët, si promovues të Reformës në Drejtësi

Edhe pse gjatë monitorimit nuk janë konstatuar media të pozicionuara kundër vettingut, siç do të shihet më poshtë, në disa prej tyre vërehet një tendencë për të amplifikuar mesazhin se Reforma në Drejtësi është para së gjithash e mbi të gjitha një investim i ndërkombëtarëve, gjë që “bën të tremben kundërshtarët e saj”.

Më datë 3 prill, “Shqiptarja.com”<sup>12</sup> ka pasqyruar në faqen nr.2 të gazetës deklaratat në mbështetje të Reformës në Drejtësi të të ngarkuarës me punë të Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë Leyla Moses-Ones, si dhe të ambasadores së Gjermanisë në Shqipëri, Susanne Schutz<sup>13</sup>. Dy shkrimet zënë të gjithë faqen nr. 2, ndërsa gjenden të pasqyruara edhe në faqen e parë.

Më datë 25 maj, “Shqiptarja.com”<sup>14</sup> shkruan, duke iu referuar shefes së ONM-së në Shqipëri, se ata që duan të pengojnë drejtësinë janë të frikësuar prej saj, duke shënuar në nëntitull se ky është një mesazh nga ndërkombëtarët për Presidentin e Republikës.

Në të njëjtën faqe gjendet një tjetër shkrim ku shefi i Zyrës së BE-së në Tiranë i përgjigjet Presidentit të Republikës me fjalinë: Reforma po bëhet sipas përcaktimeve të Kushtetutës dhe se nuk ka kthim pas<sup>15</sup>.

Deklaratat e përfaqësuesve të SHBA-ve dhe Gjermanisë në mbështetje të Reformës në Drejtësi dhe inkurajimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve për të qenë pjesë e institucioneve të reja që po ngrihen gjejnë hapësirë edhe në edicionet e lajmeve të televizioneve, megjithatë “Tema Online” e pasqyron këtë lajm duke e parë në një këndvështrim tjetër, siç është problematika që ambasadorja shtron për klimën e biznesit në vend dhe nevojën për vendime të drejta të

11 <https://www.gazetatema.net/2019/03/21/raportet-e-dsik-per-krim-dhe-korrupsion-u-perjashtuan-nga-vetingu/>

12 “SHBA: Reforma nuk ndalet, po këshillojmë prokurorët,” *Shqiptarja.com*, 3 prill 2019, f.2.

13 “Schutz: Reforma në drejtësi, një histori suksesi,” *Shqiptarja.com*, 3 prill 2019, f.2.

14 “Shefja e ONM-së: Të frikësuarit duan të pengojnë drejtësinë,” *Shqiptarja.com*, 25 maj 2019, f.4.

15 “Soreca-Metës: Reforma po zbatohet sipas Kushtetutës, s’ka kthim,” *Shqiptarja.com*, 25 maj 2019, f.4.

gjykatave<sup>16</sup>. Në të njëjtën media gjendet e pasqyruar edhe deklarata e Leyla-Moses në mbështetje të prokurorëve dhe gjyqtarëve<sup>17</sup>.

“Albeu.com”<sup>18</sup> gjithashtu i referohet deklaratës së Leyla Moses, duke e raportuar me titujt: “SHBA: Reforma po ecën para, po këshillojmë prokurorët”.

“News 24”<sup>19</sup> i referohet ambasadorit të BE në Tiranë, teksa mbështet procesin e vettingut, duke transmetuar një kronikë 1:55 minuta në edicionin qendror të lajmeve të datës 8 prill.

#### **2.4. Raportim i cunguar dhe mungesë ekspertize**

Reforma në Drejtësi dhe proceset që shoqërojnë atë, siç është vettingu apo ngritja e institucioneve që lidhen me të, janë mjaft specifike dhe kërkojnë një ekspertizë të mirëfilltë nga gazetarët që raportojnë, gjë e cila vërehet se mungon në mediat shqiptare. Kjo është një problematikë e hasur edhe në monitorimin e periudhës janar-mars 2019, duke e bërë raportimin kryesisht të cekët dhe të paplotë.

Në rastet kur kërkohet ekspertizë, sidomos për çështje që kanë të bëjnë me pasurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve apo raportimin mbi vendimet e komisioneve të vlerësimit, mediat i referohen materialeve që burojnë kryesisht nga një apo dy media të tjera.

Kjo situatë ka shkaktuar një uniformitet të informacionit, ku e njëjta përmbajtje merret dhe shpërndahet në media dhe platforma të ndryshme siç është, apo pa ndryshime të qenësishme. Gjithashtu vërehen raste të izoluara të mungesës së njohurive të gazetarëve mbi rolin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të Kolegjit të Posaçëm të Apelistit apo edhe njërive të tjera të ngritura rishtazi duke krijuar konfuzion te lexuesi.

---

16 <https://www.gazetatema.net/2019/04/02/ambasadorja-gjermane-jane-shtuar-shqetesimet-e-bizneseve-gjermane-per-tenderet/>

17 <https://www.gazetatema.net/2019/04/02/shba-po-keshillon-prokuroret-shqiptar-ambasadorja-amerikane-reforma-ne-drejttesi-po-ecen-perpara-dhe-sdo-ndalet/>

18 <http://www.albeu.com/shqiperi/shba-reforma-po-ecen-para-po-keshillojme-prokuroret/455241/>

19 <https://www.youtube.com/watch?v=0t6gCYKsRzA>

Është konstatuar se materialet e publikuara online gjenden në të njëjtën formë të nesërmen në shtyp duke i ndryshuar vetëm kohet e foljes, ku përmbajtja nuk i korrespondon profilit të gazetës që kërkon një lajm më të thelluar dhe analitik.

### **3.3. RAPORTIMI I REFORMËS NË DREJTËSI NËN TRYSNINË E KRIZËS SË FORTË POLITIKE**

Periudha e monitoruar përkon me zhvillime të rëndësishme siç janë hapat e fundit për ngritjen e SPAK-ut, si dhe vlerësimi i figurës së emrave të njohur të Sistemit të Drejtësisë në vend, ku do të veçonim kreun e Apelit të Shkodrës Fuat Vjerdha dhe debatet që e shoqëruan atë, apo rishqyrtimin nga KPA të vendimit të KPK-së për kualifikimin e kreut të Gjykatës së Lartë Xhezair Zaganjori.

Më poshtë kemi bërë një prezantim të zhvillimeve që kanë gjetur më tepër hapësirë në media gjatë periudhës së monitoruar:

#### **3.3.1. Rishqyrtimi i vendimit të kualifikimit për Xhezair Zaganjorin, mes nevojës për të vendosur standard dhe daljes jashtë funksionit të institucioneve**

Apelimi i vendimit të KPK-së për të kualifikuar kreun e Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori, është ngjarja që ka gjetur më tepër pasqyrim në mediat e monitoruara krahasuar me zhvillimet e tjera që lidhen me reformën. Ky zhvillim është ndjekur në mënyrë proaktive nga të gjashta mediat e monitoruara, me një interes të dukshëm në mediat online për vetë specifikat që lidhen me hapësirën e pakufizuar të tyre, ndryshe nga printi dhe televizionet. "Albeu.com" dhe "Tema Online" konstatohet të kenë ndjekur në vijimësi procesin që nga përcaktimi i datës kur gjykatësi do të dilte para KPA-së, detaje mbi dosjen e tij që nxiti Komisionerin Publik të apelojë vendimin e KPK-së, etj.

Në një shkrim të datës 11 qershor "Albeu.com" raporton se Zaganjori do të dalë para KPA-së më datë 25 qershor<sup>20</sup>, ndërsa në të njëjtën datë, këtij lajmi, "Tema Online"<sup>21</sup> i shton edhe detaje nga dosja e gjykatësit, duke shpjeguar se çfarë e shtyu Komisionerin Publik të mos ishte dakord me KPK-në.

---

20 <http://www.albeu.com/shqiperi/nis-seanca-per-xhezair-zaganjori-komisioneri-publik-kerkon-shkarkimin-e-kryetarit-te-gjykates-se-larte/468295/>

21 <https://www.gazetatema.net/2019/06/25/zaganjori-del-para-kpa-se-komisioneri-kpk-ka-bere-interpretim-te-gabuar-te-ligjit-ja-kater-pasurite-e-majme-qe-nuk-i-justifikon-dot/>

Po ashtu, ky zhvillim gjen hapësirë edhe në print ku "Shqiptarja.com" dhe "Shekulli" ndajnë përkatësisht 1/4 dhe 1/2 e seancës në KPA. Më 10 qershor "Shekulli" ka në faqe të parë lajmin "Kreu i Gjykatës së Lartë sërish në vetting" duke shkruar se "Përpos problemeve me pasurinë, kreu i Gjykatës së Lartë, nuk ka bindur as në kriterin e aftësive profesionale"<sup>22</sup> përmbajtje e cila gjendet të nesërmen e botuar edhe në versionin online të gazetës.

Nuk konstatohen qëndrime editoriale që lidhen me figurën e gjykatësit Zaganjori dhe as ndaj procesit të vlerësimit të tij. Mediat e monitoruara kanë një qasje neutrale. Në një pjesë të mirë të rasteve raportimet bëhen duke iu referuar përmbajtjes së materialit të ofruar nga ONM dhe më pas komisionerit publik, i cili e apeloj vendimin e kualifikimit të Zaganjorit.

### **3.3.2. Admir Thanza, gjyqtari i parë që dënohet prej një procesi që nis nga vettingu**

Vendimi i gjykatës së Tiranës për të dënuar me 9 muaj burg ish-anëtarin e Gjykatës së Lartë, Admir Thanza, është rasti i parë i dënimit të një anëtari të Sistemit të Drejtësisë për shkak të shkeljeve të zbuluara nga procesi i vettingut, prandaj përbën interes që të shihet se si është raportuar ky zhvillim në media.

Lajmi për dënimin e Thanzës me 9 muaj burg për falsifikim të formularit të vetëdeklarimit, vendim i cili u konvertua në 18 muaj shërbim prove, ka gjetur një hapësirë të madhe në mediat e monitoruara.

“News 24” e ka pasqyruar këtë zhvillim me tre kronika të ndryshme në ditë, duke filluar me pretencën më datë 17 maj, reagimin e gjyqtarit dhe vendimin e dhënë më 31 maj nga gjykata. Më 17 maj televizioni i kushton një kronikë 3:24 minuta pretencës<sup>23</sup> së prokurorisë duke e futur si një lajm të fundit në programacion, ndërkohë që u shoqërua edhe me një lidhje live nga Gjykata e Tiranës me gazetaren që mbulon këtë sektor. I njëjti lajm gjen pasqyrim edhe në edicionin e lajmeve të mbrëmjes me një kohëzgjatje 2:03 min<sup>24</sup>.

“Ora News” e raportoi pretencën e prokurorisë për Thanzën përmes një kronike me kohëzgjatje 1:19 minuta<sup>25</sup>. Ndryshe nga “News 24”, kronika e “Ora News” për Thanzën është me mbulim, ndërkohë që teksti i referohet dosjes mbi gjyqtarin, duke shtuar edhe background-in mbi procesin e shkarkimit të tij. Rezulton se gjatë periudhës së monitorimit, “Ora News” ka transmetuar

---

22 <http://shekulli.com.al/kreu-i-gjykares-se-larte-serish-nen-ethet-e-vettingut/>  
23 <https://www.youtube.com/watch?v=zseEQ4QxYiU>  
24 [https://www.youtube.com/watch?v=sLz\\_m2BhH8](https://www.youtube.com/watch?v=sLz_m2BhH8)  
25 [https://www.youtube.com/watch?v=uRJeN\\_Q-vJk](https://www.youtube.com/watch?v=uRJeN_Q-vJk)



gjithsej shtatë<sup>26</sup> kronika mbi gjyqtarin Thanza, një mesatare e lartë kjo krahasuar me mediat e tjera të monitoruara.

“Shekulli” e raportoi lajmin me një hapësirë sa 2/3 e faqes duke e pasqyruar edhe në faqen e parë, ndërsa “Shqiptarja.com” thekson në lajmin e saj të gjatë mbi këtë ngjarje se Thanza është gjyqtari i parë i dënuar nga vettingu, por që nuk do të bëjë asnjë ditë burg, pasi vendimi për 9 muaj burg është konvertuar në shërbim prove. Gazeta i referohet gjithashtu faktit se gjyqtari ka qenë pjesë e trupës gjyqësore të demonstratës së 21 janarit.

“Albeu.com”<sup>27</sup> dhe “Tema Online”<sup>28</sup> e kanë raportuar vendimin për dënimin e Thanzës si një lajm rutinë duke u mjaftuar vetëm me publikimin e vendimit, si dhe shkakun që çoi në këtë vendim pa futur background të ngjarjes.

Referuar të dhënave statistikore nga “BuzzSumo” rezulton se në të dyja platformat online audienca ka patur një reagim të vakët në rrjetet sociale për këtë zhvillim.

Nisur nga fakti se Thanza ka qenë gjyqtar në një numër të konsiderueshëm çështjesh ku janë pleksur interesa të forta politike, duke e bërë atë një emër shpesh të sulmuar edhe nga podiumet e partive, edhe qëndrimi i mediave ndaj tij ka qenë disi më specifik. Ndërkohë që mediat që shihen si më pranë opozitës kanë mbajtur një qëndrim neutral ndaj tij, mediat që shihen si më pranë qeverisë i kanë veshur lajmeve edhe një background që e lidh gjyqtarin me opozitën e sotme dhe çështje të rëndësishme, siç janë proceset gjyqësore pas demonstratës së përgjakur të “21 Janarit”.

Megjithatë, përmbajtja mediatike për Thanzën i referohet kryesisht dosjes së prokurorisë me akuzat për gjyqtarin, ndërsa vërehet një mungesë e plotë e zërit të palës së dëmtuar, në rastin konkret të gjyqtarit në kronika, artikuj të shtypit të shkruar dhe publikime të medias online.

### **3.3.3 Fuat Vjerdha, vettingu që përkon me një vendim gjyqësor mjaft të debatuar**

Procesi i vlerësimit të kreut të Gjykatës së Apelit të Shkodrës u zhvillua vetëm pak javë pas vendimit të bujshëm për heqjen e dënimit me burgim të përjetshëm për Dritan Dajtin. Megjithëse votoi pjesërisht kundër, Vjerdha ishte pjesë e trupit gjykues që mori vendimin. Ngjarja u shoqërua me një reagim të fortë shoqëror nisur nga akuzat që rëndonin mbi Dajtin.

<sup>26</sup> <http://www.oranews.tv/tag/Admir%20Thanza>

<sup>27</sup> <http://www.albeu.com/kryetitull/fshehu-denimin-per-vjedhje-ne-itali-9-muaj-burg-per-admir-thanza/464680/>

<sup>28</sup> <https://www.gazetatema.net/2019/05/31/fshehu-denimin-ne-itali-gjykata-e-tiranes-jep-vendimin-9-muaj-burg-per-admir-thanza/>

Seancat dëgjimore të KPK-së ndaj Vjerdhës u zhvilluan në atmosferën e këtij debati publik, i udhëhequr nga media dhe politika.

KPK-së i mjaftuan dy seanca dëgjimore për të vendosur se Vjerdha nuk i plotësonte kushtet për të qenë pjesë e sistemit të ri të drejtësisë. Të dyja këto seanca, si dhe e shkuara profesionale e Vjerdhës gjejnë një pasqyrim të mirëfilltë te mediat e monitoruara, ndërsa emri i tij asociohet vazhdimisht me trupin gjykues që dha vendimin për Dajtin.

Kështu “News 24” publikon një material bruto<sup>29</sup> prej 4:46 minuta të seancës së parë dëgjimore të Vjerdhës, më datë 6 maj, ndërsa bëhet edhe një parashtrim i pasurisë së tij, kurse më datë 13 qershor përmes një kronike relativisht të gjatë prej 2:40 minuta zbardhet vendimi i KPK për shkarkimin e tij, si dhe deklarata e gjyqtarit se “largohej me kokën lart nga ajo sallë”<sup>30</sup>.

“Ora News” ndërkohë rezulton të ketë transmetuar katër kronika me një kohëzgjatje totale prej 5:13 minuta, të cilat mbulojnë procesin nga seanca e parë dëgjimore e tij për KPK deri te shkarkimi<sup>31</sup>. Televizioni e thekson që në titull se Vjerdha ishte anëtar i trupit gjykues që liruan Dritan Dajtin nga burgimi i përgjeshëm duke thënë: Shkarkohet gjyqtari Fuat Vjerdha, që votoi kundër Dritan Dajtit<sup>32</sup>, ndërsa “News 24” i referohet gjithashtu të shkuarës profesionale të gjyqtarit duke sjellë dy vendime. I pari lidhet me lirimin e një personazhi që më pas do të vriste dy turistë në Dukagjin dhe tjetri me një vendim kundër lirit të një personazhi të njohur të krimin në vend.

Ndërkohë “Shekulli” kishte paralajmëruar shkarkimin e gjyqtarit që më datë 7 maj përmes një lajmi me titull: “14 denoncimet e qytetarëve rrezikojnë gjyqtarin e Dritan Dajtit, Fuat Vjerdhën”. Shkrimi zë një pozicion qendror në faqet 12-13, ndërsa është pasqyruar edhe në faqe të parë. Përmbajtja i referohet procesit të vettingut dhe denoncimeve të ardhura në emër të gjyqtarit. Lajmi për denoncimet ndaj gjyqtarit gjendet i pasqyruar edhe tek “Tema Online”<sup>33</sup> përmes një shkrimi të postuar fillimisht në “Birn”.

“Shekulli” ndërkohë e pasqyron në faqe të parë shkarkimin e Vjerdhës duke e atashuar sërish emrin e tij me gjyqin ndaj Dajtit, ndërkohë që gjen hapësirë sa ¼ faqes arsytimi i gjyqtarit se është larguar pa të drejtë.

Ndryshe nga “Shekulli”, gazeta “Shqiptarja.com” e pasqyron lajmin e shkarkimit të gjyqtarit së bashku me një gjyqtare tjetër për të cilët KPK dha vendimin njëkohësisht.

29 <https://www.youtube.com/watch?v=Mwx5xtgVFWM>

30 <https://www.youtube.com/watch?v=5TMrjQ2oIls>

31 <https://www.youtube.com/watch?v=MhoTdjh9veM>

32 <http://www.oranews.tv/article/kpk-shkarkon-kryetarin-e-gjykates-se-apelit-ne-shkoder-fuat-vjerdha>

33 <https://www.gazetatema.net/2019/05/06/denoncimet-i-hapin-telashe-gjyqtarit-fuat-vjerdha/>

Një raportim i ngjashëm është bërë edhe nga Albeu.com<sup>34</sup>, ndërsa një muaj para shkarkimit portali i referohej vetëdeklarimit të pasurisë së gjyqtarit<sup>35</sup>.

## **PËRFUNDIME**

Periudha nën monitorim përkon me një ndër krizat më të forta politike të vendit duke bërë që edhe vëmendja e redaksive të lajmeve të orientohet nga zhvillimet në spektrin politik. Shpesh herë këto akuza janë lidhur edhe me zhvillimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me Reformën në Drejtësi, ku mazhoranca akuzon opozitën se i frikësohet institucioneve të reja të drejtësisë, ndërsa opozita i referohet faktit se ka një tendencë për të kapur Sistemin e Drejtësisë nga qeveria.

Megjithatë, pavarësisht përplasjes së fortë politike, zhvillimet më të rëndësishme kanë gjetur hapësirë në mediat e monitoruara, të cilat kanë raportuar në pjesën më të madhe të rasteve vetëm duke iu referuar fakteve dhe jo deklaratave, si dhe kundër deklaratave politike. Kjo ka ndodhur sepse Reforma në Drejtësi shihet nga media si një mundësi për vendin për të dalë njëherë e mirë nga tranzicioni thuajse 30-vjeçar, për të vendosur më në fund një shtet ku mbizotëron e drejta dhe ligji.

Pavarësisht politikës editoriale, nuk janë konstatuar media kundër Reformës në Drejtësi, megjithatë në redaksitë që shihen si më pranë opozitës vërehet shqetësimi se ajo nuk po bëhet siç duhet. Kësaj fryme i kanë shërbyer edhe vendime të caktuara të komisioneve të vlerësimit duke kualifikuar nga njëra anë si të përshtatshëm për të vijuar detyrën individë të përfolur për afëra dhe duke shkarkuar nga ana tjetër gjyqtarë apo prokurorë të njohur në rrethin e tyre si figura të pastra.

Konsolidimi i KLP-së dhe KLGJ-së si edhe avancimi i punës për ngritjen e SPAK-ut ka bërë që edhe raportimet në media të shmangen nga mbulimi vetëm i seancave të vettingut, siç ndodhte kryesisht gjatë fillimit të vitit.

Raportimi mbi Reformën në Drejtësi mbetet një sfidë për median dhe gazetarët shqiptarë për shkak të ndryshimeve thelbësore që vërehen në gjithë Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri. Kjo bën që punonjësit e medias të hasin vështirësi në njohjen e funksioneve dhe mënyrën e organizimit të institucioneve të reja, duke bërë që në raste të caktuara të hasen raportime të cunguara dhe të pasakta. Kësaj i shtohen edhe mungesat financiare dhe mungesa e stabilitetit të përgjithshëm të

<sup>34</sup><http://www.albeu.com/shqiperi/shkarkohen-nga-detyra-kreret-e-gjykatave-ne-tirane-dhe-shkoder/466124/>

<sup>35</sup> <http://www.albeu.com/kryetitull/kryetari-i-apelit-shkoder-rritje-stratosferike-te-pasurise-nga-viti-fillestar-foto-lajm/460446/>

medias në Shqipëri; si rrjedhojë në redaksi mungojnë gazetarët që kanë ekspertizën e duhur mbi zhvillimet e mbi Reformën në Drejtësi.

Kriza politike ka bërë që vëmendja e saj të përqendrohet tek kundërshtari dhe jo te zhvillimet në Reformën në Drejtësi. Për rrjedhojë edhe raportimi i medias, ndryshe nga periudha e mëparshme (janar-mars 2019) të mos i referohet diskutit politik, por të qëndrojë kryesisht në rrafsh teknik mbi zhvillime në komisionet e vlerësimit të figurës apo institucionet e ngritura rishtazi.

Në këtë situatë, prioriteti në lajm është diktuar nga zhvillimi apo personazhi i përfshirë dhe jo nga deklaratat politike.

*Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).*



Norwegian Embassy



**PARTNERS**ALBANIA  
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT